

DHUNA DHE REPRESIONI SERBE NË KOMUNËN E ISTOGUT,
RAST STUDIMI MASAKRA E DUBRAVËS
EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA:

ARBNORE SYLAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

PRILL, 2022

DHUNA DHE REPRESIONI SERBE NË KOMUNËN E ISTOGUT, RAST STUDIMI MASAKRA E DUBRAVËS

Mentori: Prof. Dr. Nuri Bexheti

Kandidat-ja: Arbnore Sylaj

Në këtë punim, kam trajtuar dhe përshkruar kryesisht dhunen dhe represionin serb në komunën e Istogut duke filluar që nga vitet e 90' e deri tek viti 1999, ku u bë çlirimi i Kosovës. Përshkrimin dhe hulumtimin e historisë për këtë komunë e kam filluar jo rastësisht por me kaq intersuar prej kohësh, duke mbledhur materiale dokumentare, të shkruara, arkivore. Për këtë tëmë shumë më heret më ka ardhur idea dhe e kam ndjehur si obligim të shkruaj si një historiane e re pasi që jam edhe vet nga kjo komunë dhe shumë ngjarje gjatë këtyre viteve i kam përjetuar edhe vet unë. Në këtë komunë jo vetëm që ka pasur dhunë ndaj popullatës po ka pasur edhe masakra të shumta si në tërë Kosovën.

Materia e këtij punimi është e përbërë nga tre kapituj, të cilët janë punuar me analizë dhe trajtim të materialeve të disponueshme; libra, dokumente arkivore, si dhe intervista me personalitete të ndryshme.

Kapitulli i Parë i punimit trajton: Dhunën dhe represionin serb në Kosovë në fillim të viteve 90'. Në këtë kapitull hyrës është paraqitur: Kundërvënien e organizuar e shqiptarëve gjatë viteve 1990-1998, dhuna serbe mbi shkollën shqipe si dhe shkatërrimi i pronësisë private dhe objekteve fetare.

Kapitulli i Dytë trajton: Komunën e Istogut gjatë viteve 1997-1999, mizorit serb, masakrat, dëbimet e dhunshme dhe arrestimet si dhe të vrarët, të zhdukurit, të plagosurit dhe të burgosurit nga serbet në komunën e Istogut.

Kapitulli i Tretë trajton: Vrasjet në burgun e Dubravës gjatë vitit 1999, ky kapitull përmban edhe disa intervista me ish të burgosurit politikë në burgun e Dubravës ku tregojnë për tmerrin që kanë parë dhe përjetuar në këtë burg.

Dhuna dhe terrori shtetëror serbo-malazez mbi popullsinë shqiptare të rrethit të Istogut, në përmasat e veta më tragjike, është bërë edhe për disa arsye strategjike të këtyre shteteve, të cilat kanë pasur qëllim copëtimin e tërësisë territoriale të tokave shqiptare. Ky rreth ishte njëcak i veçantë për shkak

se shtrihet në pjesën më veriore të Dukagjinit,që më tutje lidhet territorialisht me viset e vjetra shqiptare të Sanxhakut,në veri,dhe nga Pazari i Ri e Plava dhe Guçia,në veriperëndim. Zotërimi i kësaj zone,me ndyshimin e dhunshëm të strukturës etnike të popullsisë në favor të sllavëve,do të thotë shkëputje e lidhjeve të drejtpërdrejta dhe tradicionale të popullësisë së Rrafshit të Dukagjinit me vëllezërit e vet të gjuhës dhe të gjakut në anën e sotme të Sanxhakut dhe të viseve të tjera boshnjake,andej nga Mali i Zi dhe Bosnja. Një faktor tjetër që do të ketë ndikuar në përmasat e këtij terrori,me të gjitha karakteristikat e zhdukjes fizike të një populli,mund të ketë qenë edhe pasuria natyrore që ka kjo trevë.Vërtet,Rrethi i Istogut nuk ka miniera,por ka një tokë shumë pjellore që shtrihet në fushat veriore të Dukagjinit pranë Bjeshkëve të Moknës. Këtë fushë e përshkojnë tre lumenj: Drini i Bardhë,Lumi i Istogut dhe ai i Vrellës,si dhe disa lumenj më të vegjël.Në këto anë ka pasur përmasa të një rezistence active edhe Lëvizja kaçake. Ndoshta edhe për shkak të maleve të larta,që shtrihen deri në 2.150 metra,këtu kanë qëndruar dhe kanë gjetur strehim,por edhe aktivisht kanë vepruar krerët e kësaj lëvizjeje me çetat e veta. Ndër kaçakët më të njohur të Rrethit të Istogut kanë qenë: Beqir e Zeqir Rexha,Kamber Loshi,Miftar Dauti,Nak Berisha,Bardh Isufi,Ramë Alia-Bajramaj i Istogut e të tjerë. Popullsinë shqiptare të Istogut nuk e kursyen as partizanët. Gjatë vitit 1944-1945 janë pushkatuar, therur dhe mbytur pa gjyq mbi 400 shqiptarë.

Mirëpo gjatë luftës se fundit ky rajon u sulmua keqas gjatë marsit,prillit,majit dhe qershorit të vitit 1999. Pothuajse e tërë popullësia u dëbua,në Istog në një shtëpi të familjes së Gusturanëve,mbetën peng 250-300 shqiptarë. Në fillim të vitit 1999,Komuna e Istogut kishte 52 vendbanime me 57.000 banorë. Prej tyre janë vrarë 183 civilë dhe 36 dëshmorë, 34 janë të zhdukur,55 të burgosur dhe 63 të plagosur.Po ashtu është bërë edhe shkatërrim i madh ekonomik. Gjatë vitit 1999 në Istog nga 52 fshatra,sa ka pasur kjo komunë,50 janë djegur, nga 5.267 shtëpi janë djegur tërësisht apo pjesërisht 4.207 shtëpi, 254 shtëpi kanë qenë të granatuara,ndërkaq të plaçkitura kanë qenë 3.168 shtëpi, 5 objekte shoqërore, 264 objekte afariste, 6 objekte fetare, 527 automjete, 268 traktorë,12 kombajna.Kjo komunë, pra bashkë me Gjakovën, Pejë, Deçanin hyn në radhën e komunave që ka pësuar shkatërrimet më të mëdha ekonomike në Kosovë.